L I G J
Nr.8366, datë 2.7.1998

PËR SHËRBIMIN GJEOLOGJIK SHQIPTAR (SHGJSH)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë detyrat, bazat, parimet e organizimit e të drejtimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) me përjashtim të Shërbimit Gjeologjik të Naftës e Gazit.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

1, "Shtet" - kuptohet Republika e Shqipërisë.

2. "Qeveri" - kuptohet Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

3. "Ministri"- kuptohet ministria që mbulon veprimtarinë e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

4. "Ministër"- kuptohet ministri i ministrisë që mbulon veprimtarinë.

5. "Person"- kuptohet një person flzik a juridik.

6. "Mineral"- kuptohet çdo substancë në gjendje të ngurtë, të lëngët e të gaztë që ndodhet në trajtë natyrore mbi ose nën tokë, në ose nën ujë dhe në shkëmb, formuar prej proceseve gjeologjike.

7. "Mineral i dobishëm" - kuptohet përcaktimi i dhënë në pikën 6, duke shtuar se plotëson kushtet gjeologjike, minerare, teknologjike për përdorimin me efektshmëri në degë të ndryshme të ekonomisë.

8. "Rezerva ujore" - kuptohen të gjitha ujërat e brendshme sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike që i mbushin ato.

9. "Basen ujor" - ka kuptimin që jepet në ligjin "Për rezervat ujore".

10. "Kërkim"- kuptohet faza metodike e kryerjes së vrojtimeve, studimeve dhe punimeve gjeologjike komplekse, që synon vlerësimin cilësor dhe jep rekomandime për më tej.

11."Vlerësim" - kuptohet përcaktimi cilësor e sasior i mineralit në përputhje me kërkesat tekniko-ekonomike të çdo stadi studimor.

12. "Agrogjeologji" - kuptohet studimi kompleks i tokës për përdorimin efektiv dhe mbrojtjen e saj.

13. "Autoritet shkencor - kuptohet një person me gradë shkencore, titull shkencor ose veprimtari të gjerë kërkimore-shkencore.

KREU II
OBJEKTI I SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Neni 3

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është person juridik publik, buxhetor, organ këshillimor teknik i shtetit, që me porosi të tij kryen veprimtari gjeologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është në varësi të ministrit dhe e ka selinë e tij qendrore në Tiranë.

Neni 5

Shteti, i përfaqësuar nga ministria,është zotëruesi i vetëm i kapitalit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe ushtron të drejtën e tij si pronar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Objekt i veprimtarisë të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar është:

- Studimet gjeologjike sistematite bazë të vendit nëpërmjet kartografimit kompleks të shkallëve të ndryshme.
- Studime gjeofizike e gjeokimike të çdo shkalle.
- Kërkimi dhe vlerësimi i mineraleve metalore dhe jometalore, burimeve ujore nëntokësore, ujërave të pijshëm e industrialë, ujërave mineralë e termale.
- Studimet hidrogjeologjike për rivlerësimin e baseneve ujore dhe për caktimin e masave për ruajtjen e rezervave ujore.
- Studimet gjeologjike për mjedisin.
- Studimet gjeologo-inxhinierike.
- Studimet agrogjeologjike, studimet për erozionin.
- Rilevimet topografike të shkalleve të ndryshme dhe matjet gjeodezike.
- Krijimi i bazës së të dhënave gjeologjike e të mineraleve të dobishme, vënia në dispozicion e këtyre të dhënave organeve të pushtetit qendror e lokal dhe subjekteve të tjera të interesuara, përgatitja, publikimi dhe komercializimi i informacionit gjeologjik.

Neni 7

Shërbimi Gjeologjik i Shqipërisë ka të drejtë dhe detyrë të grumbullojë në Arkivin Qendror të Gjeologjisë të gjithë informacionin e dokumentacionin e përfituar deri tani dhe atë qe do të përfitohet në të ardhmen në fushën e gjeologjisë bazë, të gjeofizikës, gjeokimisë, hidrogjeologjisë, gjeologjisë inxhinierike, topogjeodezisë, kampionaturën, mostrat e dublikatet e tyre, të sistemojë, të ruajë, të përpunojë e të informatizojë dhe t'i përdorë (për vete e të tretët) sipas rregullave që përcaktohen në aktet nënligjore.

Në Arkivin Qendror të Gjeologjisë arkivohet informacioni gjeologjik, të cilin zotëruesi i lejes minerare e dorëzon në Drejtorinë e Përgjithshme të Minierave, duke respektuar kërkesat e nenit 110 të ligjit minerar. Në këtë arkiv arkivohet edhe dokumentacioni gjeologjik krahinor që del nga studimet për naftën dhe gazin.

Neni 8

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar kryen veprimtari edhe me të tretët. Për veprimtari jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë merr miratim nga ministri.

KREU III
ORGANIZIMI

Neni 9

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar drejtohet nga një këshill drejtues i përbërë nga 7 anëtarë, të cilët emërohen nga ministri për një afat 4-vjeçar me të drejtë përsëritjeje një herë. Ata nuk mund të jenë persona të punësuar në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, me përjashtim të drejtorit të përgjithshëm, si dhe nuk mund të jenë persona që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose interesa me këtë shërbim.

Neni 10

Këshilli drejtues i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar përbëhet nga
1. Kryetari, i cili duhet të jetë person me autoritet shkencor.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
3. Një përfaqësues i ministrisë.
4. Një përfaqësues i organit qeveritar të zhvillimit dhe bashkëpunimit ekonomik.
5. Tri autoritete shkencore me përvojë pune në fushën e gjeologjisë.
Shpërblimi i anëtarëve të këshillit drejtues përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 11
Kompetencat e këshillit drejtues

Këshilli dreitues ka këto kompetenca:
1. Merr vendime për zbatimin e politikave të zhvillimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, si dhe për drejtimet e përgjithshme të veprimtarisë së tij.
2. Kontrollon zbatimin e programit të zhvillimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
3. Kontrollon bilancin vjetor të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe ia paraqet për shqyrtim e miratim ministrit.
4. I paraqet ministrit për miratim programin e zhvillimit për vitin pasardhës.
Vendimet e këshillit drejtues merren me shumicë të thjeshtë votash.
Në rast rezultati të barabartë votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 12

Ministri ka të drejtë ta thërrasë këshillin drejtues sa herë që ai e gjykon të nevojshme, të marrë pjesë në mbledhje dhe ta drejtojë atë pa të drejtë vote.

Neni 13

Drejtimi administrativ i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar bëhet nga drejtori dhe, në mungesë të tij nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm.

Neni 14

Drejtori dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm emërohen nga ministri për një periudhe 4-vjeçare, me të drejtë përsëritjeje.

Këta duhet të jenë persona me autoritet shkencor dhe me përvojë pune në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Neni 15

Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm

Drejtori i përgjithshëm ka këto kompetenca:

- drejton dhe është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të këshillit drejtues;
- vendos për të gjitha problemet, me përjashtim të atyre që janë në kompetencë të këshillit drejtues;
- përfaqëson Shërbimin Gjeologjik Shqiptar në marrëdhëniet me të tretët.

Neni 16

Rregullat e funksionimit të organeve drejtuese të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar përcaktohen me një rregullore të vecantë që miratohet nga ministri.

Neni 17

Struktura organizative e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ndërtohet në përputhje me objektin e veprimtarisë së këtij shërbimi, propozohet nga këshilli drejtues dhe miratohet nga ministri.

Pagat e punonjësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

MËNYRA DHE BURIMET E FINANCIMIT

Neni 18

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar financohet nga buxheti i shtetit kundrejt programeve të zbërthyera në projekte që paraqiten çdo vit në Qeveri nepërmjet ministrisë. Me miratimin nga Qeveria të programit, merr rrugë edhe financimi i projekteve. Ministria kontrollon realizimin e këtij financimi sipas projekteve.

Neni 19

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar paraqet e merr miratim nga ministria dhe organi qeveritar për zhvillimin dhe bashkëpunimin ekonomik për pjesëmarrje në projekte dypalëshe ose shumëpalëshe.

Neni 20

Të ardhurat që Shërbimi Gjeologjik Shqiptar siguron nga veprimtaria me të tretët, me autorizim të ministrit, i përdor për fuqizimin e Shërbimit Gjeologjik me makineri e mjete teknologjike, aparatura laboratorike e pajisje për mjediset e punës dhe kualifikimin e specializimin e personelit të këtij shërbimi.

Neni 21

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë Anonime "Gjeoalba" (Sh. A. " GJEOALBA"') , SH. A. " Hidrogjeologji " dhe SH. A " Gjeologji-Gjeodezi " në përputhje me legjislacionin në fuqi, i kalojnë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Neni 22

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministria të nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr., datë .7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani